

# KUSHTETUTA E REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE E SHQIPËRISË

(Tiranë, më 28.12.1976 Nr.: 5506)

## HYRJE

Populli shqiptar e ka çare rrugën e historisë me shpatë në dorë. Në përleshje me armiqtë e jashtëm e të brendshëm, ai mbrojti qenien si popull e si komb, luftoi për lirinë e pavarësinë kombëtare, për tokën dhe gjuhën amtare, për bukën dhe drejtësinë shoqërore. Pas shekujsh robërie ai arriti një fitore të madhe me krijimin e shtetit të pavarur kombëtar shqiptar më 28 Nëntor 1912.

Lëvizja kombëtare, demokratike dhe revolucionare mori një vrull e përmbajtje të re me triumfin e Revolucionit të Madh Socialist të Tetorit dhe me përhapjen e ideve komuniste, që shënuan një kthesë vendimtare edhe për fatet e popullit shqiptar.

Në gjendjen e rëndë të pushtimit fashist e nazist, i tradhtuar nga klasat sunduese, populli shqiptar, nën udhëheqjen e Partisë Komuniste të Shqipërisë (sot Partia e Punës), u ngrit në këmbë dhe, i bashkuar në Frontin Nacionalçlirimtar, me armë në dorë u hodh në luftën më të madhe të historisë së tij për çlirimin kombëtar dhe shoqëror. Në zjarrin e luftës për liri, mbi gërmadhat e pushtetit të vjetër lindi shteti i ri shqiptar i demokracisë popullore, si formë e diktaturës së proletariatit. Më 29 Nëntor 1944 Shqipëria fitoi pavarësinë e vërtetë dhe populli shqiptar mori në dorë fatet e tij. Triumfoi revolucioni popullor dhe u hap një epokë e re, epoka e socializmit.

Në kushtet e pushtetit popullor, nën udhëheqjen e Partisë së klasës punëtore, u realizuan shndërrime të mëdha ekonomiko-shoqërore, që u përvijuan në Kushtetutën e parë të shtetit socialist shqiptar. U dha fund sundimit të kapitalit të huaj dhe grabitjes së pasurive të vendit. Kapitalistët e çifligarët u shpronësuan dhe mjetet kryesore të prodhimit kaluan në duart e popullit. U hap rruga për industrializimin socialist të vendit. Reforma Agrare ia dha tokën atij që e punon dhe kolektivizimi i bujqësisë e futi fshatin në rrugën e socializmit.

Vendin e pronës private dhe të ekonomisë shumëformëshe e zuri prona shoqërore mbi mjetet e prodhimit dhe sistemi i vetëm i ekonomisë socialiste në qytet e në fshat. U likuiduan klasat shfrytëzuese dhe shfrytëzimi i njeriut prej njeriut. Gjithë zhvillimi shoqëror bëhet në mënyrë të vetëdijshme, me plan dhe në interes të popullit.

Në Shqipërinë socialiste klasa punëtore është klasa udhëheqëse e shtetit dhe e shoqërisë. Marrëdhënie të reja ndihme reciproke dhe bashkëpunimi janë vendosur midis dy klasave mike të shoqërisë sonë, klasës punëtore dhe fshatarësisë kooperativiste, si edhe shtresës së inteligjencies popullore. Puna e lirë e njerëzve të lirë është bërë faktori vendimtar i lulëzimit të atdheut socialist, i ngritjes së mirëqënies së përgjithshme dhe të gjithsecilit. Shqipëria e kapërceu prapambetjen shekullore dhe është shndërruar në një vend me industri e bujqësi të përparuar.

U çliruan forcat e gjalla të popullit dhe shpërthyen energjitë e tij krijuese të pashtershme. Gruaja shqiptare në procesin e pandërprerë të revolucionit fitoi barazinë në të gjitha fushat, u bë një forcë e madhe shoqërore dhe shkon drejt emancipimit të saj të plotë. Arsimi e kultura janë bërë pronë e masave të gjera të popullit dhe shkencat e dituria janë vënë në shërbim të shoqërisë. U shemben bazat e obskurantizmit fetar. Figura morale e njeriut punonjës, ndërgjegjja dhe botëkuptimi i tij formohen në bazë të ideologjisë proletare, e cila është ideologjia sunduese.

Socializmi e tregoi gjithë epërsinë e tij mbi rendin e vjetër shfrytëzues.

Shqipëria ka hyrë në etapën e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste. Shndërrimet e mëdha historike kanë krijuar kushte të reja për zhvillimin e vazhdueshëm të revolucionit socialist.

Zhvillimi i luftës së klasave në dobi të socializmit, forcimi i vazhdueshëm i shtetit të diktaturës së proletariatit dhe thellimi i demokracisë socialiste, zhvillimi i forcave prodhuese dhe përsosja e marrëdhënieve socialiste në prodhim, ngritja e pandërprere e mirëqëniesë masave punonjëse, ngushtimi gradual i dallimeve midis industrisë e bujqësisë, qytetit e fshatit, punës mendore e punës fizike, afirmimi i personalitetit të njeriut brenda kolektivitetit socialist, zotërimi i teknikës dhe i shkencës së kohës, revolucionarizimi i vazhdueshëm i gjithë jetës së vendit janë rrugët e gjera nëpër të cilat forcohet dhe ecën përpara shoqëria socialiste.

Populli shqiptar është i vendosur të mbrojë nga çdo armik pavarësinë kombëtare, pushtetin popullor dhe fitoret e veta socialiste. Shqipëria socialiste është gjithnjë një faktor aktiv në luftën për çlirimin kombëtar e shoqëror, për paqen, lirinë dhe të drejtat e të gjithë popujve kundër imperializmit, reaksionit dhe revizionizmit. Në politikën e saj të jashtme ajo udhëhiqet nga idealet e mëdha të socializmit e të komunizmit dhe lufton për ngadhënjimin e tyre kudo në botë.

Populli shqiptar ka gjetur dhe gjen frymëzim të vazhdueshëm në doktrinën e madhe të marksizëm-leninizmit, nën flamurin e së cilës, i bashkuar rreth Partisë së Punës dhe nën udhëheqjen e saj, ai çon përpara ndërtimin e shoqërisë socialiste për të kaluar pastaj gradualisht në shoqërinë komuniste.

### **Neni 1**

Shqipëria është Republikë Popullore Socialiste.

### **Neni 2**

Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë është shtet i diktaturës së proletariatit, që shpreh e mbron interesat e të gjithë punonjësve.

Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë mbështetet në unitetin e popullit rreth Partisë së Punës të Shqipërisë dhe ka në themel aleancën e klasës punëtore me fshatarësinë kooperativiste nën udhëheqjen e klasës punëtore.

### **Neni 8**

Organet përfaqësuese zgjidhen nga populli me votim të përgjithshëm, të barabartë, të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë.

Zgjedhësit kanë të drejtë të heqin në çdo kohë përfaqësuesin e tyre, kur ky ka humbur besimin politik, kur nuk plotëson detyrat e ngarkuara ose kur vepron në kundërshtim me ligjet.

Organizimi dhe menyra e zhvillimit të zgjedhjeve rregullohen me ligj.

### **Neni 15**

Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë në marrëdhëniet e jashtme udhëhiqet nga parimet e marksizëm-leninizmit dhe të internacionalizmit proletar, ndjek politikën e miqësisë, të bashkëpunimit dhe të ndihmës reciproke me shtetet socialiste, përkrah lëvizjen revolucionare të klasës punëtore dhe luftën e popujve për liri, pavarësi, përparim shoqëror e socializëm dhe mbështetjetë solidaritetin e tyre.

Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë është për paqen dhe fqinjësinë e mirë, për marrëdhënie me të gjitha shtetet mbi bazën e barazisë, të respektimit të

sovrانيتit, të mosndërhyrjes në punët e brendshme dhe të dobisë reciproke.

Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë kundërshton çdo formë të agresionit, të shfrytëzimit kolonial, të tutelës, të diktatit dhe të hegjemonisë, të shtypjes kombëtare e të dallimit racor. Ajo i përmbahet parimit të vetëvendosjes së popujve, të ushtrimit të sovranitetit të plotë kombëtar dhe të barazisë së të gjitha vendeve në marrëdhëniet ndërkombëtare.

### **Neni 33**

Arsimi në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë organizohet e drejtohet nga shteti, është i hapur për të gjithë dhe jepet falas; ai ndërtohet mbi bazën e botëkuptimit marksist-leninist dhe kombinon mësimin me punën prodhuese dhe me edukimin fizik e ushtarak.

Arsimi ndjek traditat më të mira të shkollës shqipe kombetare e laike.

### **Neni 35**

Shteti mbron trashëgimin kulturor të popullit dhe kujdeset për zhvillimin e gjithanshëm të kulturës kombëtare socialiste

Shteti përkrah zhvillimin e letërsisë dhe të artit të realizmit socialist, që u përmbahen idealeve të socializmit e të komunizmit dhe përshkohen nga fryma kombëtare e popullore.

### **Neni 37**

Shteti nuk njeh asnjë fe dhe përkrah e zhvillon propagandën ateiste për të rrënjosur te njerëzit botëkuptimin materialist shkencor.

### **Neni 40**

Të gjithë shtetasit janë të barabartë përpara ligjit.

Nuk njihet asnjë kufizim ose privilegj në të drejtat dhe detyrat e shtetasve për arsye seksi, race, kombësie, arsimi, pozite shoqërore a gjendjeje materiale.

### **Neni 42**

Pakicave kombëtare u sigurohet mbrojtja e zhvillimi i kulturës dhe i traditave popullore, përdorimi i gjuhës amtare dhe mësimi i saj në shkollë, zhvillimi i barabartë në të gjitha fushat e jetës shoqërore.

Çdo privilegj a pabarazi kombëtare dhe çdo veprim që shkel të drejtat e pakicave kombëtare është antikushtetues dhe dënohet sipas ligjit.

### **Neni 52**

Shtetasit kanë të drejtë për arsim.

Arsimi tetëvjeçar është i përgjithshëm dhe i detyrueshëm. Shteti synon ngritjen e shkallës së arsimit të detyrueshëm për të gjithë.

### **Neni 53**

Shtetasit gëzojnë lirinë e fjalës, të shtypit, të organizimit, të grumbullimit, të

mbledhjes dhe të manifestimit publik.

Shteti garanton realizimin e këtyre lirive, krijon kushte për to dhe vë në dispozicion mjetet e nevojshme materiale.

#### **Neni 54**

Shtetasve u sigurohet e drejta e bashkimit në organizata të ndryshme që veprojnë në fushën politike, ekonomike, kulturore, si edhe në çdo fushë tjetër të jetës së vendit.

#### **Neni 55**

Ndalohet krijimi i çfarëdo organizate me karakter fashist, antidemokratik, fetar dhe antisocialist.

Ndalohet veprimtaria dhe propaganda fashiste, antidemokratike, fetare, luftënxitese, antisocialiste, si edhe nxitja e urrejtjes kombëtare e racore.

#### **Neni 65**

Në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë u jepet e drejta e strehimit shtetasve të huaj që ndiqen për shkak të veprimtarisë së tyre në dobi të revolucionit e të socializmit, të demokracisë e të çlirimit kombëtar si edhe të përparimit të shkencës e të kulturës.

#### **Neni 102**

Gjykatat gjykojnë çështjet penale e civile, si edhe çështje të tjera që me ligj janë lënë në kompetencën e tyre.

Gjykimi bëhet me pjesëmarrjen e ndihmësgjyqtarëve dhe me dyer të hapura, me përjashtim të rasteve kur me ligj është caktuar ndryshe.

Gjate gjykimit përdoret gjuha shqipe. Personat që nuk dinë shqip, mund të përdorin gjuhën e tyre dhe të flasin me ndihmën e një përkthyesi.

I pandehuri gëzon të drejtën e mbrojtjes.

#### **Neni 112**

Kjo Kushtetutë hyn në fuqi menjëherë.

## **Verfassung der Sozialistischen Volksrepublik Albanien**

vom 28. Dez. 1976

### **EINFÜHRUNG**

Das albanische Volk hat sich den Weg der Geschichte mit dem Schwert in der Hand gebahnt. In Auseinandersetzung mit äußeren und inneren Feinden verteidigte es seine Existenz als Volk und Nation, kämpfte es für Freiheit und nationale Unabhängigkeit, für Boden und Muttersprache, für Brot und soziale Gerechtigkeit. Nach Jahrhunderten der Knechtschaft errang es mit der Schaffung eines unabhängigen albanischen Nationalstaates am 28. November 1912 einen großen Sieg. Die nationale, demokratische und revolutionäre Bewegung erhielt mit dem Triumph der Großen Sozialistischen Oktoberrevolution und mit der Verbreitung der kommunistischen Ideen, die eine entscheidende Wende auch für die Geschicke des albanischen Volkes bezeichneten, einen neuen Aufschwung und einen neuen Inhalt.

In der schwierigen Situation der faschistischen und nazistischen Besetzung erhob sich das albanische Volk, von den herrschenden Klassen verraten, unter der Führung der kommunistischen Partei Albaniens (heute Partei der Arbeit) und nahm, in der Nationalen Befreiungsfront zusammengeschlossen, mit der Waffe in der Hand den größten Kampf seiner Geschichte für die nationale und soziale Befreiung auf. Im Feuer des Freiheitskampfes erstand auf den Trümmern der alten Staatsmacht der neue volksdemokratische albanische Staat als Form der Diktatur des Proletariats. Am 29. November 1944 erlangte Albanien die wahre Unabhängigkeit, und das albanische Volk nahm seine Geschicke selbst in die Hand. Es triumphierte die Volksrevolution, und eine neue Epoche ward eingeleitet, die Epoche des Sozialismus.

Unter den Bedingungen der Volksmacht wurden unter der Führung der Partei der Arbeiterklasse große wirtschaftliche und gesellschaftliche Umwälzungen verwirklicht, die in der ersten Verfassung des sozialistischen albanischen Staates ihren Ausdruck fanden. Der Herrschaft des ausländischen Kapitals und der Plünderung der Reichtümer des Landes ward ein Ende gesetzt. Die Kapitalisten und Großgrundbesitzer wurden enteignet, und die wesentlichen Produktionsmittel gingen in die Hände des Volkes über. Der Weg für die sozialistische Industrialisierung des Landes ward frei. Die Agrarreform gab den Boden dem, der ihn bestellt, und die Kollektivierung der Landwirtschaft brachte das Dorf auf den Weg des Sozialismus. An die Stelle des Privateigentums und der vielgestaltigen Wirtschaft trat das gesellschaftliche Eigentum an den Produktionsmitteln und das einheitliche System der sozialistischen Wirtschaft in Stadt und Land. Beseitigt wurden die Ausbeuterklassen und die Ausbeutung des Menschen durch den Menschen. Die gesamte gesellschaftliche Entwicklung erfolgt zielbewußt, planmäßig und im Interesse des Volkes.

Im sozialistischen Albanien ist die Arbeiterklasse die führende Klasse des Staates und der Gesellschaft. Neue Beziehungen, die auf gegenseitiger Hilfe und Zusammenarbeit beruhen, sind zwischen den beiden befreundeten Klassen unserer Gesellschaft, der Arbeiterklasse und der Genossenschaftsbauernschaft sowie der Schicht der Volksintelligenz hergestellt worden. Die freie Arbeit freier Menschen ist der entscheidende Faktor der Blüte des sozialistischen Vaterlandes, der Hebung des allgemeinen und des individuellen Wohlstands geworden. Albanien überwand die jahrhundertalte Rückständigkeit und hat sich zu einem Land mit fortgeschrittener Industrie und Landwirtschaft gewandelt.

Die lebendigen Kräfte des Volkes wurden freigesetzt, und seine nicht versiegenden schöpferischen Energien brachen hervor. Die albanische Frau gewann im ununter-

brochenen Prozeß der Revolution die Gleichberechtigung auf allen Gebieten, wurde eine große gesellschaftliche Kraft und geht ihrer vollständigen Emanzipation entgegen. Bildung und Kultur sind Eigentum der breiten Massen des Volkes geworden, und Wissenschaft und Wissen sind in den Dienst der Gesellschaft gestellt. Die Grundlagen des religiösen Obskurantismus wurden niedergerissen. Die moralische Gestalt des werktätigen Menschen, sein Bewußtsein und seine Weltanschauung bilden sich auf der Grundlage der proletarischen Ideologie, welche die herrschende Ideologie ist.

Der Sozialismus erwies seine ganze Überlegenheit über die alte Ausbeuterordnung. Albanien ist in die Etappe des vollständigen Aufbaus der sozialistischen Gesellschaft getreten. Die großen historischen Umwälzungen haben neue Bedingungen für die ständige Entwicklung der sozialistischen Revolution geschaffen. Die Entwicklung des Klassenkampfes zugunsten des Sozialismus, die ständige Festigung des Staates der Diktatur des Proletariats und die Vertiefung der sozialistischen Demokratie, die Entwicklung der Produktivkräfte, die Vervollkommnung sozialistischer Verhältnisse in der Produktion, die ununterbrochene Hebung des Wohlstands der werktätigen Massen, die schrittweise Verringerung der Unterschiede zwischen Industrie und Landwirtschaft, zwischen Stadt und Land, zwischen geistiger und körperlicher Arbeit, die Bestätigung der Persönlichkeit des Menschen im sozialistischen Kollektiv, die Beherrschung der zeitgemäßen Technik und Wissenschaft, die ständige Revolutionierung des gesamten Lebens des Landes sind die breiten Wege, auf denen sich die sozialistische Gesellschaft festigt und auf denen sie voranschreitet.

Das albanische Volk ist entschlossen, seine nationale Unabhängigkeit, seine Volksmacht und seine sozialistischen Errungenschaften gegen jeden Feind zu verteidigen. Das sozialistische Albanien ist stets ein aktiver Faktor im Kampf für die nationale und soziale Befreiung, für den Frieden, die Freiheit und die Rechte aller Völker gegen Imperialismus, Reaktion und Revisionismus. In seiner Außenpolitik läßt es sich von den großen Idealen des Sozialismus und des Kommunismus leiten und kämpft für ihren Siegeszug überall in der Welt.

Das albanische Volk fand und findet in der großen Lehre des Marxismus-Leninismus ständige Inspiration. Unter ihrem Banner treibt es, geschart um die Partei der Arbeit und von ihr geführt, den Aufbau der sozialistischen Gesellschaft voran, um schrittweise in die kommunistische Gesellschaft überzugehen.

#### **Art. 1**

Albanien ist eine Sozialistische Volksrepublik.

#### **Art. 2**

Die Sozialistische Volksrepublik Albanien ist ein Staat der Diktatur des Proletariats, der die Interessen aller Werktätigen vertritt und verteidigt.

Die Sozialistische Volksrepublik Albanien stützt sich auf die Einheit des Volkes, das sich um die Partei der Arbeit Albaniens schart, und hat das Bündnis der Arbeiterklasse mit der Genossenschaftsbauernschaft unter der Führung der Arbeiterklasse zur Grundlage.

#### **Art. 8**

Die Vertretungsorgane werden vom Volke in allgemeiner, gleicher, unmittelbarer und geheimer Wahl gewählt.

Die Wähler haben das Recht, ihren Vertreter jederzeit abzurufen, wenn dieser das

politische Vertrauen verloren hat, wenn er die ihm übertragenen Aufgaben nicht erfüllt oder wenn er gegen die Gesetze handelt.

Die Organisation und die Art der Durchführung der Wahlen werden gesetzlich geregelt.

#### **Art. 15**

Die Sozialistische Volksrepublik Albanien läßt sich in ihren auswärtigen Beziehungen von den Prinzipien des Marxismus-Leninismus und des proletarischen Internationalismus leiten, verfolgt eine Politik der Freundschaft, der Zusammenarbeit und der gegenseitigen Hilfe mit den sozialistischen Staaten, unterstützt die revolutionäre Bewegung der Arbeiterklasse und den Kampf der Völker für Freiheit, Unabhängigkeit, gesellschaftlichen Fortschritt und Sozialismus und stützt sich auf ihre Solidarität.

Die Sozialistische Volksrepublik Albanien ist für Frieden und gute Nachbarschaft, für Beziehungen mit allen Staaten auf der Grundlage der Gleichheit, der Achtung der Souveränität, der Nichteinmischung in die inneren Angelegenheiten und des gegenseitigen Vorteils.

Die Sozialistische Volksrepublik Albanien widersetzt sich jeder Form der Aggression, der kolonialen Ausbeutung, der Bevormundung, des Diktates und der Hegemonie, der nationalen Unterdrückung und der Rassentrennung. Sie hält sich an das Prinzip der Selbstbestimmung der Völker, der Ausübung der vollen nationalen Souveränität und der Gleichheit aller Länder in den internationalen Beziehungen.

#### **Art. 33**

Die Bildung in der Sozialistischen Volksrepublik Albanien wird vom Staat organisiert und geleitet, ist allen zugänglich und wird kostenlos erteilt; sie beruht auf der Grundlage der marxistisch-leninistischen Weltanschauung und verbindet den Unterricht mit produktiver Arbeit und mit körperlicher und militärischer Erziehung.

Die Bildung folgt den besten Traditionen der nationalen und weltlichen albanischen Schule.

#### **Art. 35**

Der Staat schützt das Kulturerbe des Volkes und sorgt für die allseitige Entwicklung der sozialistischen nationalen Kultur.

Der Staat fördert die Entwicklung der Literatur und der Kunst des sozialistischen Realismus, die sich an die Ideale des Sozialismus und des Kommunismus halten und von nationalem und volksverbundenem Geist durchdrungen werden.

#### **Art. 37**

Der Staat erkennt keinerlei Religion an und fördert und betreibt atheistische Propaganda, um in den Menschen die wissenschaftliche materialistische Weltanschauung zu verwurzeln.

#### **Art. 40**

Alle Staatsbürger sind vor dem Gesetz gleich.

Irgendeine Beschränkung oder irgendein Vorrecht in den Rechten und Pflichten der Staatsbürger aus Gründen des Geschlechtes, der Rasse, der Nationalität, der Bildung, der gesellschaftlichen Stellung oder der materiellen Lage wird nicht anerkannt.

**Art. 42**

Den nationalen Minderheiten wird der Schutz und die Entwicklung der Kultur und der Volkstraditionen, der Gebrauch der Muttersprache und ihre Unterrichtung in der Schule, die gleiche Entwicklung auf allen Gebieten des gesellschaftlichen Lebens zugesichert.

Jedes nationale Vorrecht oder jede nationale Ungleichheit und jede Handlung, die die Rechte der nationalen Minderheiten verletzt, ist verfassungswidrig und wird gemäß dem Gesetz bestraft.

**Art. 52**

Die Staatsbürger haben das Recht auf Bildung. Die achtjährige Schulbildung ist allgemein und verbindlich. Der Staat strebt die Hebung des obligatorischen Bildungsgrades für alle an.

**Art. 53**

Die Staatsbürger genießen Rede-, Presse-, Organisations- und Versammlungsfreiheit und die Freiheit der öffentlichen Kundgebung. Der Staat garantiert die Verwirklichung dieser Freiheiten, schafft die Bedingungen dafür und stellt die erforderlichen materiellen Mittel zur Verfügung.

**Art. 54**

Den Staatsbürgern wird das Recht der Vereinigung in verschiedenen Organisationen, die auf politischem, wirtschaftlichem, kulturellem sowie auf jedem anderen Gebiet des Lebens des Landes tätig sind, zugesichert.

**Art. 55**

Verboten ist die Schaffung jeder Art von Organisation faschistischen, antidemokratischen, religiösen und antisozialistischen Charakters. Verboten ist faschistische, antidemokratische, religiöse, kriegshetzerische, antisozialistische Tätigkeit und Propaganda sowie Anstiftung zu Völker- und Rassenhaß.

**Art. 65**

In der Sozialistischen Volksrepublik Albanien wird ausländischen Staatsbürgern Aufenthaltsrecht gewährt, die wegen ihrer Tätigkeit für die Revolution und den Sozialismus, die Demokratie und die nationale Befreiung sowie für den Fortschritt der Wissenschaft und der Kultur verfolgt werden.

**Art. 102**

Die Gerichte verhandeln Straf- und Zivilsachen sowie andere Sachen, die gemäß dem Gesetz in ihre Zuständigkeit fallen.

Die Verhandlung erfolgt öffentlich unter Teilnahme von Hilfsrichtern, mit Ausnahme der im Gesetz anders geregelten Fälle.

In der Verhandlung wird die albanische Sprache benutzt. Personen, die des Albanischen nicht mächtig sind, können ihre Sprache benutzen und sich eines Dolmetschers bedienen.

Der Angeklagte genießt das Recht auf Verteidigung.

**Art. 112**

Diese Verfassung tritt mit sofortiger Wirkung in Kraft

Quelle: Gazeta Zyrtare e Republikës Popullore të Shqipërisë. Tiranë 1976, S. 75-104.  
Quelle auf Deutsch: Brunner, Georg u. Boris Meissner (Hrsg.): Verfassungen der kommunistischen Staaten. Paderborn, München, Wien, Zürich 1980, S. 26-44.